

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E ENJTE DATA 13 PRILL 2023

Si anëtare e Komisionit të Medies do të doja të kisha pasur emrin në listën e folësve, por duke qenë se nuk pata mundësi ta marr fjalën, po kërkoj të paktën tri minuta për të folur për këtë projektligj. Parafolësitim do të doja t'i thosha që foltorja, të cilën ne e përmendim shumë herë, nuk duhet përdorur për fushatë elektorale, sepse nuk mendoj se është vendi i duhur. Duke qenë se po diskutojmë për ligjin e medies, mendoj se të paktën duhet të flasim për të drejtat themelore të njeriut dhe se si ato duhen respektuar. Si respektohen sot e drejta e informimit, liritë dhe të drejtat e njeriut kur edhe në këtë sallë asgjë nuk shkon siç duhet, kur edhe kjo foltore përdoret për fushatë elektorale, për të abuzuar dhe për të linçuar një gjuhë urrejtjeje ndaj çdo deputeti të kësaj sale? Në fakt, ka ardhur momenti që të flasësh në këtë sallë është bërë e kotë pasi nuk ka ndërgjegjësim të kësaj qeverie për të ndërmarrë masa të vërteta dhe reale. Ligji për të cilin ne po flasim sot nuk duhet të kishte kaluar në mënyrë të përshpejtuar, por duhet të ishte diskutuar thellësisht në të gjitha komisionet përkatëse për t'u përafuar 100% me direktivat e BE-së dhe të mos ishte i paplotë.

Ne e dimë çfarë ka ndodhur muajt e fundit, jemi në dijeni të sulmeve që janë bërë ndaj gazetarëve, ndaj medieve të shumta, ndonjëherë edhe me pasoja humbje jete. Këto janë kambana alarmi, ndaj të gjithë ne duhet të jemi përballë përgjegjësisë për të kontribuar me diskutime konstruktive për të arritur më të mirën në ligjin tonë, për sigurinë dhe garantimin e të drejtave të njeriut dhe për të mos pasur më probleme të tilla. Megjithatë, nuk mendoj se diçka të tillë do të ndodhë, sepse qeveria e mendon këtë sallë si një platformë ku mund t'i caktojë çdo deputeti kur të flasë, si të flasë, si të qëndrojë, sa të flasë dhe kur të mos thotë asgjë ndaj qeverisë, e cila në të vërtetë nuk e ka bërë detyrën e saj, nuk po arrin dot të ecë përpara, sepse i ka akoma sytë tek e kaluara e errët që e mban peng Shqipërinë. Faleminderit!